



OPŠTINA PRISHTINA
REPUBLIKA KOSOVA
01-1086

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Prishtina – Municipality of Prishtina	
---	--	---

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21,22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 Nr.350/02-96635/21 dt. 31.05.2021, të pronarit Selatin Kllokoqi nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, në lagjën “Sofalia”, Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 20.08.2021, merr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore pronarit Selatin Kllokoqi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr.350/02-96635/21 dt. 31.05.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, me etazhitet B+P+1, në lagjën “Sofalia”, Prishtinë në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” 2016-2024, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 847-4, ZK Sofali.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të: Plani Rregullues i Hollësishëm “Sofalia” 2016-2024, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.031-247790 dt. 04.10.2016, dhe kjo zonë sipas Informim nga Plani Rregullues i Hollësishëm “Sofalia” 2016-2024, është e planifikuar me destinim banimi - “banim individual i ulët”;

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcela kadastrale e trajtuar, sipas gjendjes faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - nr. 847-4, me S=429 m², me pronar Selatin Kllokoqi, “Pyjor-Mal i klasës I”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale të lartcekur nuk ka ndërtesa të ndërtuara, ndërsa. në rrethinë ka ndërtesa individuale banimi;
- Terreni është i pjerrët, me rënie në drejtimin lindje-perëndim , me disnivel ~5.0 m`;
- Parcela ka qasja në rrugë lokale ekzistuese dhe në rrugë të planifikuar;

IV. Kushtet ndërtimore për rregullimin dhe realizimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, të objektit janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhitei i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në dispozitën urbanistike, e cila i është bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;

individuale të banimit, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje, etazhitet dhe kritere të tjera normative-ligjore, sipas llogarive dhe projekt propozimit, si në vijim:

Shtëpi individuale banimore B+P+1

$S=396.18 \text{ m}^2$ / sipërfaqe mbitokësore $S=278.47 \text{ m}^2$, sipërfaqe nëntokësore $S=117.71 \text{ m}^2$;

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës është $S=429.0 \text{ m}^2$, e cila shtrihet brenda vijës rregulluese;

- Etazhiteti i lejuar për objekte sipas Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, duhet të jetë max. P+2;
Sipas projekt propozimit B+P+1;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore - brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e shputës së ndërtesës, sipas Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, është max.30%:
 $S=429.0 \times 0.3=128.70 \text{ m}^2$ / sipas Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024,
 $S=122.09 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit;
- Bazuar në kriteret e Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, koeficienti ndërtimor është i përcaktuar me etazhitet maksimal P+2 dhe ajo sipërfaqe ndërtimore do të llogaritet si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** mbi tokë- suteren dhe **0%** për etazhet e nëntokës-bodrumet;
- Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore të parcelës (ISPN) është 0.8, dhe bazuar në kriteret e planit duhet të jetë;
 $S=429.0 \times 0.8=343.20 \text{ m}^2$ / sipas Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024,
 $S=278.47 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max. 50%, bazuar në Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, dhe kjo sipërfaqe duhet të jetë:
 $S=429.0 \times 0.5=214.50 \text{ m}^2$ / sipas Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024,
 $S=117.71 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit,
- Koeficienti minimal i shfrytëzimit të parcelës me gjelbërim (ISHPGJ) është min. 50%, bazuar në Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, dhe ajo duhet të jetë:
 $S=429.0 \times 0.5=214.50 \text{ m}^2$ / sipas Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024,
 $S=215.7 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Qasja në ndërtesë të jetë nga rruga e planifikuar ose rruga e miratuar e bllokut;
- Distanca minimale e objektit nga bordura e rrugës, duhet të jetë:
- E përcaktuar sipas Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024;
- Distanca e objektit nga kufiri me parcelat fqinje duhet të jetë:
- për fasada me kthina primare $L=0.5 \text{ H}$,
- për fasada me kthina sekondare $L=0.2 \text{ H}$,
- me marrëveshje me fqinun $L \geq 0$;
- Kuota e përdhësës mund të jetë më së shumti 1.4 m mbi kuotën e rrugës nga e cila ka qasje dhe nuk mund të jetë më e ulët se kuota e nivelit të rrugës;
- Arkitektura- dukja e jashtme (fasadat) e ndërtesës dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore, me masa të eficientës së energjisë, të qëndrueshme dhe duhet t'i përshtatet ndërtesave të rrethinës;
- Për shtëpi individuale banimore duhet të sigurohet 1 vendparkim/për njësi;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve nuk duhet të dal jashtë parcelës ndërtimore.

- Të bëhet aplikimi i të gjitha kriterëve, normave dhe standardeve urbane, të planifikimit dhe arkitektonike të përcaktuara nga Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024.

V. Kycja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kycje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të ndërtesës (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kycja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kycje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a dhe PTK.

VI. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Inçizimin gjeodezik;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50 m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhese, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, 3D - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës, kanalizim dhe rrjetin e energjisë elektrike;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore - zeytare, me paramasë dhe parallogari;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe të mbrojtjes nga zhurma, me analiza konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme

VII. Paga e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcela kadastrale nr.847-4, ZK Sofali, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar si kulturë "Mal i klasës 1", dhe me Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, kjo hapësirë është e planifikuar për destinim banimi – "banim individual i ulët", për ndërtimin e ndërtesës sipas kërkesës për marrje të lejes ndërtimore, duhet të bëhet ndërrimi i destinimit të shfrytëzimit. Ky ndërrim realizohet duke u bazuar në Ligjin nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, neni 11 dhe 13, dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 41/2006, neni 7, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore me nr. 847-4, me S=429 m². Kjo sipërfaqe do të regjistrohët si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

Sofali, në bazë të Çertifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar si kulturë "Mal i klasës I", me sipërfaqe S=429 m², dhe sipas Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, në këtë parcelë lejohet ndërtim i ulët me destinim banimi, kjo drejtori jep pëlqimin që parcelës kadastrale nr. 847-4, ZK Sofali, t'i ndërrohet destinimi në parcelë me shfrytëzim ndërtimi.

VIII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës dhe investitorit);

IX. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

X. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Pronari/aplikuesi Selatin Kllokoqi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr.350/02-96635/21 dt. 31.05.2021, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë Çertifikatë dhe Kopja e planit, për parcelën kadastrale nr. 847-4, ZK Sofali, me pronar Selatin Kllokoqi.
- Inçizimi gjeodezik i parcelës kadastrale nr. 847-4, ZK Sofali, punuar nga gjeodeti i licencuar Sabri Zylfiu, me licencë nr.81;
- Shkresën "Informim nga Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, me referencë: 04-350/01-82219/21 dt. 11.05.2021 të datës 21.05.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm – Prishtinë;
- Aktin noterial "Pëlqim" me Numrin Rendor i LRP 2442/2021, të datës 11.05.2021, të lidhur te notere Merita Kostanica Ukaj, me të cilin Avdullah Hoti, në cilësinë e pronarit



të parcelës kadastrale nr. 847-3, ZK Sofali, i jep pëlqim Selatin Kllokoqi-t, pronar i parcelës kadastrale nr. 847-4, ZK Sofali, të ndërtojë në distancë deri 1 m` nga kufiri i parcelës së tij;

- Projektin konceptual arkitektonik, të hartuar nga N.SH. "Kutia", e regjistruar në ARBK, me nr. të biznesit 70884771, me seli në Prishtinë, rr. "Fehmi Agani", nr.23/9, me projektuese përgjegjëse ida Tringa Ferri Arapi;
- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve tatimore, në emër të Ardiana Gashi Kllokoqi, sipas kërkesës së Selatin Kllokoqi, me nr. 82081/21 (9489388934) dt. 11.05.2021;
- Fotokopjen e dokumentit të identifikimit të pronarit;
- Fotot e lokacionit.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ka pranuar kërkesën 05 Nr.350/02-96635/21 dt. 31.05.2021, të pronarit Selatin Kllokoqi nga Prishtina, me anë të së cilës kërkohet caktimi i kushteve ndërtimore, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor – projektin ideor, për ndërtimin e ndërtesës, shtëpi individuale banimore, me etazhitet B+P+1, në lagjen Sofali, konkretisht në parcelën kadastrale nr.847-4, ZK Sofali, e cila shtrihet në kuadër të Planit Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024.

Gjatë fazës së shqyrtimit të kërkesës, nga gjetjet në arkivën e drejtorisë është evidentuar që, kjo drejtori ka caktuar kushte ndërtimore për parcelën e njëjtë, me "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 Nr.350/02-0196372/18 dt. 25.01.2019, me të cilën është miratuar zgjidhja urbane për pesë parcela kadastrale, me pëlqimin e të gjithë pronarëve. Meqë vlefshmëria e Vendimit të cekur më sipër ishte një (1) vit, me mundësi vazhdimi për një (1) vit tjetër, dhe pronari nuk ka aplikuar për vazhdim të vlefshmërisë, ka skaduar afati i vlefshmërisë për kushte ndërtimore, andaj, pronari ka aplikuar për caktim të kushteve ndërtimore.

Pas kontrollimit të projektit konceptual nga përgjegjësi për komunikacion i kësaj drejtorie, i njëjti ka konstatuar si në vijim: "Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Selatin Kllokoqi, në Sofali, Prishtinë, lidhur me kërkesën e kushteve ndërtimore të lëndës 05-350/02-96635/21 dt.31.05.2021, kyçja për automjete në rrugën e brendshme të bllokut me nr. të parcelës 847-1, ZK Sofali, e cila në bazë të kushteve gjeometrike është e paraparë të funksionoj si rrugë një kahore, e cila lidhet me rrugë të planifikuar të Planit Rregullues "Sofalia", për ndërtesën banimore – shtëpi individuale me etazhitet B+P+1, andaj kjo zgjidhje urbane mund të pranohet si e tillë. Kyçja duhet t'i përshtatet teknikisht rrugës dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale e vertikale në lokacionin e kyçjes dhe në kohën kur realizohet ajo."

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenit 12 dhe 13 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, si dhe pas përfundimit të procedurës së vendosjes së njoftimit publik, i cili ka qëndruar në lokacion për 5- pesë ditë (05.08.2021 – 10.08.2021), meqenëse gjatë kësaj kohe nuk është pranur ndonjë koment apo sugjerim, ka konstatuar se, kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të dokumentit të planifikimit hapësinor për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit, dy kësaj drejtorie, në dosje të lëndës 05 Nr.350/02-96635/21 dt. 31.05.2021 dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 350/02-96635/21 DT. 20.08.2021**

Zyrtar:
Liridon Gashi



U.d. Udhëheqëse e Sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtoria:
Ardian Çllufi

